



Në bazë të nenit 68 paragrafi 68.1 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dhe nenit 13 të statutit të Komunës së Dragashit 01nr.06-103/1 i datës 11.09.2008, neni 6 pika 1.3 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunë, neni 8 i Rregullorës për Transparencë 01 Nr.060-6335/1 e datës 27.04.2017 kryetari i Komunës cakton:

TAKIMIN e I-rë PUBLIK

I cili do të organizohet me dt. 13.06.2022 ditë e Hënë, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Dragash, duke filluar në ora 10:00.

Qytetarë të nderuar të komunës së Dragashit, ju ftojmë të merrni pjesë në Takimin e I-rë Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve, komuna e Dragashit përdor mekanizmin e konsultimeve dhe pjesmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në konsultimet, vlerësimet, vërejtjet, propozimet për çështjet që janë në interes të qytetarëve.

Andaj i lusim qytetarët e komunës së Dragashit që të marrin pjesë në këtë takim dhe të shfrytëzojnë mundësinë për të diskutuar çështjet me rëndësi dhe me interes për Komunën.

02 Nr. 020/01-11375/22

datë:26.05.2022

Me respekt,

Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini

